

**Arben Xhaferi** ka lindur më 27 mars 1969. Aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Politikave dhe Koordinimit Territorial në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku është përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e veprimtarisë së prefektëve të qarkut.

Prej muajit prill 2021, ai ushtron këtë funksion drejtues në Ministrinë e e Punëve të Brendshme. Më herët, gjatë periudhës maj 2018 – mars 2021, ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Juridike në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës të Akredituara nga Bashkimi Europian (AAPAA), ku ka qenë përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe kontabilitetit të institucionit.

Gjatë viteve 2015 – 2018 ka punuar në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) si Përgjegjës i Sektorit të Financës, duke mbuluar çështjet financiare dhe kontabël të agjencisë.

Në periudhën 2014 ka ushtruar profesionin e ekonomistit në sektorin privat, ndërsa nga viti 2011 deri në vitin 2014 ka qenë Përgjegjës Finance për investime në fushën e ndërtimit. Më herët, në vitet 2007 – 2009 ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Importit në një shoqëri private, si dhe ka punuar si specialist logjistike.

Përgjatë viteve 1998 – 2005 ka qenë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku ka ushtruar funksionin e specialistit të procedurave doganore. Karrierën e tij profesionale e ka nisur në fillim të viteve '90 në sektorin e tregtisë dhe shpërndarjes.

Z. Xhaferi ka përfunduar studimet universitare në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë, profili Financë, si dhe studime të mëtejshme në Fakultetin e Gjuhës Angleze në Universitetin e Gjirokastrës. Ai ka ndjekur gjithashtu stazhin profesional për marrjen e titullit “Ekspert Kontabël i Autorizuar” pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Ai zotëron njohuri të mira në përdorimin e programeve kompjuterike si Microsoft Word, Excel, programe financiare si “Alfa Accounting” dhe “Finance 5”.